



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **59**

Prishtinë, më 8.12.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Hestet Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Elheme Hetemi, Dragiša Mirić, Myrvete Pantina, Zef Morina, Zulf Merxha, Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : nga MMPH dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i p/l për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Naser Rugova-kryetar konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryetari hapi shqyrtimin e projektligjit duke dhënë sqarime të duhura fillimisht nga zyrtarët e MMPH **Flutra Pula dhe Nazmi Shkodra** të cilët me disa sugjerime kontribuan që komisioni të sjellë me konsensus vërejtjet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 2, definicionet në vijim riformulohen :

“treguesi mjedisor”-tregues që jep të dhëna për cilësinë e mjedisit duke e bërë atë të perceptueshme përmes vlerës numerike, matjes dhe komunikimit.

“monitorimi”- procesi i përcjelljes dhe matjeveve sistematike të treguesve mjedisor;

Titulli i definicionit “norma e cilësisë së ajrit” ndryshon dhe bëhet **“vlera kufitare e cilësisë së ajrit”**.

Definicioni **“norma e shkarkimeve në ajër”** fshihet.

Tek definicioni **“autoriteti për mbrojtjen e ajrit”** në fund fjala “Ministria” zëvendësohet me **“Qeveria”**, ndërkaq në definicionin e radhës (emision) fjala e fundit “ambiental” bëhet **“mjedisor”**, poashtu edhe në definicionin **“aglomerati”**.

Pas definicionit “vlerësimi” definicioni **“vlera kufitare e emisionit”(VKE)** riformulohet: **vlera kufitare e emisionit (VKE)- sasia më e madhe e lejuar e ndotësit, që shkarkohet në ajër nga një burim ndotjeje, niveli i të cilit është caktuar në bazë të diturisë shkencore, me qëllim të shmangies, parandalimit ose zvogëlimit të efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisit në tërësi, që duhet të arrihet brenda periudhës së caktuar dhe mos të tejkalohet kur është arritur.**

Tek definicioni **“vlera e synuar”** në reshtin e 5 fjala **“që duhet”** fshihet, ndërsa **“arrihet”** bëhet **“arrihen”**.

“pragu i alarmit”- niveli përtej së cilës ekziston rreziku për shëndetin e njeriut nga ekspozimi i shkurtër i ndotjes për të cilën duhet të ndermirren masat e menjëhershme.

“margjina e tolerancës”-përqindja e vlerës kufitare e cila vlerë mund të tejkalohet sipas kushteve të përcaktuara me akte nënligjore.

“pragu i informimit”- vlera përtej së cilës ekziston rreziku për shëndetin e njeriut nga ekspozimi i shkurtër, në veçanti për pjesën e popullatës së ndjeshme, për të cilën është i nevojshëm informimi i menjëhershëm.

“zona”-pjesë e territorit ku janë të përcaktuar kufijtë me qëllim të vlerësimit dhe menaxhimit të cilësisë së ajrit.

Pas definicionit “zona” shtohen definicionet :

zona e veçantë – zonë e përcaktuar nga ministria dhe pushteti lokal (komuna) që kërkojnë mbrojtje të veçantë të cilësisë së ajrit.

zona me mbrojtje të veçantë- zona e përcaktuar nga ministria dhe pushteti lokal (komuna) që i tejkalojnë normat e cilësisë së ajrit dhe që kërkojnë mbrojtje të beçante të cilësisë së ajrit.

Pas definicionit “aglomerati” shtohet definicioni :

gazrat serre janë gazrat në atmosferë që absorbojnë dhe emitojnë rrezatim brenda spektrit infrakuq(termik).

Në definicionin **“kundërmimet”** fjala **“ndjenjën”** zëvendësohet me **“shqisën”**, si dhe në definicionin **“burim”** fjalia **“pikëlore dhe difuzëve”** bëhet **“pikore dhe difuzive”**.

Në definicionin **“Ministri”** në reshtin e parë fshihet **“Ministrisë”**.

Amendamenti 2

Neni 3, Nëntitullit “Treguesit bazë” i shtohet edhe një fjalë dhe bëhet “**Treguesit bazë mjedisor**”.

Përmirësohet fjalia e parë në paragrafin 1 :

“Treguesit mjedisor bazë” bëhet “**Treguesit bazë mjedisor**”.

Paragrafi 2 dhe 3 riformulohen si vijon :

2. Treguesit tjerë mjedisor të cilësisë së ajrit me akt të veçantë nënligjor i përcakton ministria dhe i njofton subjektet fizike dhe juridike.

3. Treguesit tjerë mjedisor të cilësisë së ajrit për zona të veçanta dhe në varësi të natyrës së shkarkimeve në ajër, i përcakton Qeveria me akt nënligjor me propozim të ministrisë.

Amendamenti 3

Neni 4, në paragrafin 1, në fund pas fjalës “fuqi” teksti në vijim riformulohet “**i përcakton Qeveria me akt nënligjor me propozim të ministrisë.**”

Paragrafi 2, në fund pas fjalës “vendor” vihet pikë ndërsa teksti “**si dhe standardeve të BE**” fshihet.

Amendamenti 4

Neni 5, në paragrafin 1.3, në reshtin e 2 fshihet “**edhe**”, ndërsa në reshtin e 8 pas fjalës “lëndëve” fshihet “**të**”. Tek paragrafi 1.4 në reshtin e 1 fshihet “**të cilat**”.

Paragrafi 2 riformulohet :”**Qeveria me propozim të ministrisë do të rregullon me akte nënligjore çështjet e administrimit të burimeve të reja të ndotjes deri më tani të panjohura.**”

Amendamenti 5

Neni 6, riformulohet:

“**Qeveria me propozim të ministrisë i përcakton vlerat kufitare të emisioneve (VKE) në ajër, konform standardeve të BE dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë.**”

Amendamenti 6

Neni 7, paragrafi 1, në fund pas fjalës “ligji” shtohet presja dhe vazhdon teksti i riformuluar “**mund të zbatohen vlerat e përkohshme kufitare të emisioneve.**”

Paragrafi 2 riformulohet :”**Vlerat e përkohshme kufitare të emisioneve, mënyra e vendosjes, dhe kohëzgjatja e zbatimit të tyre, miratohen me akt të veçantë nga Qeveria me propozimin e ministrisë.**”

Amendamenti 7

Neni 8, paragrafi 1, në reshtin e 2 fjala “pastërtinë” zëvendësohet me “**cilësinë**”, po në këtë resht fjala “mbrojnë” zëvendësohet me “**mbrojtje**”, në reshtin e 4 “ushtron” zëvendësohet me “**ushtrohen**”.

Amendamenti 8

Neni 9, Në titull fjala “kryesore” zëvendësohet me “**e veçanta**”.

Amendamenti 9

Neni 10, paragrafi 1, në fund fshihet “**si dhe impiante me fuqi termike më të vogël se 50MWt**”.

Pas paragrafit 3 përmirësohet numri 3 dhe bëhet 4.

Amendamenti 10

Neni 14, paragrafi 1, në reshtin e 6 pas fjalës “grimcave” fshihet “**dhe**”, në vazhdim fjala “oksideve” zëvendësohet me “**monoksidi i**”.

Amendamenti 11

Neni 15, titulli riformulohet “**Burimet e vogla të ndotjes**”.

Paragrafi 1, në reshtin e 3 pas fjalës “shtëpiake” riformulohet fjalia “**dhe burimet e vogla të ndotjes**”, vazhdon “fuqia termike...”.

Paragrafi 3, në fund pas fjalës “monitorim” riformulohet fjalia ekzistuese dhe bëhet “**nga burimet e vogla të ndotjes**”.

Paragrafi 4, fshihet.

Amendamenti 12

Neni 16, paragrafi 1, në reshtin e 5, pas numrit 2014, teksti në vijim deri në fund fshihet.

Paragrafi 4, në fund pas “përcaktuara” shtohet “**me akt nënligjor**”, ndërsa në vazhdim “autoriteti kompetent” zëvendësohet me “**Qeveria me propozim të Ministrisë**”.

Amendamenti 13

Neni 19, paragrafi 3, në fund pas fjalës “raportin” shtohet “**Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe institucioneve të BE-së**” ndërsa teksti ekzistues deri në fund fshihet.

Amendamenti 14

Neni 21, paragrafi 2 shndërrohet në paragrafin 4, në reshtin e parë të së cilës pas fjalës “projektet” shtohet “**të miratuara nga Qeveria**”.

Në vend të paragrafit 2 vihet teksti si vijon :

”2. Kriteret, kushtet dhe procedurat për stimulimin e masave të zhvillimit të pastër i përcakton Qeveria me akt të veçantë me propozim të ministrisë.”

Paragrafi 3, në fund pas fjalës “Ministria” riformulohet fjalia “**në koordinim me Qeverinë dhe në bashkëpunim me organizatat tjera relevante**”.

Pas paragrafit 3 shtohet një paragrafi :

“4. Vendimet rreth miratimit të programeve dhe projekteve bëhen publike në afat prej 5 ditë pune”.

Amendamenti 15

Neni 22, paragrafi 3, fjala “Agjencionin” bëhet “**Entit**”.

Amendamenti 16

Neni 23, paragrafi 1, në fund hiqet pika dhe shtohet “**dhe bëhen publike**”.

Amendamenti 17

Neni 24, riformulohet :

Neni 24

Masat për tejkalimin e pragut të alarmit dhe cilësinë e dobët të ajrit

1. Kur pragu i alarmit tejkalohet dhe përcaktohet cilësi e dobët e ajrit, Ministria përcakton masat paralajmëruese dhe informon Qeverinë, autoritetet relevante lokale dhe publikun.

2. Për parashikimin dhe paralajmërimin e gjendjes së smogut ose situatave me cilësi të dobët të ajrit, Qeveria me propozim të Ministrisë, me akt të veçante, përcakton masat për rregullimin e sistemit special paralajmërues.

3. Në raste emergjente, për të normalizuar gjendjen,masat e ndërmarra duhet të koordinohen nga Ministria, Qeveria dhe dhe autoritetet lokale-komunat.

4. Ministria përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e shkarkimit në ajër nga burimet e ndotjes

5. Autoritetet lokale në bashkëpunim me Ministrinë, duhet të ndërmarrin masa emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit..

6. Autoriteti lokal përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e burimeve të emisioneve të ndotësve në ajër.

7. Për të zvogëluar ndotjen dhe përmirësuar cilësinë e ajrit, operatorët duhet t'i zhvillojnë dhe aplikojnë masa preventive.

8. Operatorët duhet të ndërmarrin masat emergjente, për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit.

9. Operatorët duhet të informojnë në mënyrë periodike Ministrinë, publikun dhe autoritetet lokale për masat preventive të aplikuara për zvogëlimin e ndotjes.

Amendamenti 18

Neni 25 paragrafi 1 fjala “azhurnuara” bëhet “përditësuara”, ndërsa tek Neni 29 dhe 30, në reshtin e parë të të dy neneve pas fjalës “ajrit” shtohet teksti “për periudhën dhjet (10) vjeçare”.

Amendamenti 19

Neni 31, paragrafi 1, në reshtin e 2 pas fjalës “ajrit” shtohet “për periudhën pesë (5) vjeçare”.

Amendamenti 20

Neni 33, pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri :

2. “Raportet e monitorimit bëhen publike”.

Amendamenti 21

Neni 35, në fund shtohet një paragraf :

“3. Kriteret, kushtet dhe procedurat për projektet nga paragrafi 2 i këtij neni i përcakton Qeveria me akt të veçantë me propozim të ministrisë”.

Amendamenti 22

Neni 36, në reshtin e 1 pas fjalës “Qeveria” shtohet “me propozim të ministrisë”.

Amendamenti 23

Neni 38, paragrafi 1.1.19 fjala “smogut” zëvendësohet me “cilësisë së ajrit”.

Amendamenti 24

Neni 39 paragrafi 1, fshihen nënparagrafet 1.5,1.6,1.7 dhe 1.8.

Amendamenti 25

Neni 40, paragrafi 1, fjala e parë “Kuvendi” fshihet.

Duke pasur parasysh vërejtjet e zyrtarëve të MMPH rreth dispozitave ndëshkimore, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Deri më datën 11.12.2009 ministria e mjedisit duhet të harmonizoi dispozitat ndëshkimore të projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, dhe ti sjell në grupin punues më 10.12.2009 në orën 11,00 të harmonizuara, përndryshe projektligji do të procedohet me sugjerimin e komisionit për divizionin e standardizimit, që dy versionet tjera të nenit 38 dhe 39 t'i përshtaten versionit shqip.

4. Të ndryshme

Kryetari fillimisht kërkoi fjalën e **Zef Morinës** rreth projektligjit për Shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore. I njëjti njoftoi komisionin për takimin e tij me disa anëtar të komisionit për komunitete nga të cilët u njoftua se ndoshta kemi të bëjmë edhe me interesa të ngushta, sepse me gjasë në kohën e votimit në komision ka munguar përfaqësuesi serb por pastaj është problematizuar me të marr vesh për miratimin e amendamenteve, ndaj është propozuar themelimi i grupeve punuese me ndërkombëtarët. Sugjeroi një takim të përbashkët me këtë komision.

Me këtë sugjerim nuk u pajtua **Naim Maloku** sepse ky komision është funksional dhe nuk mund të zgjerohet edhe ndaj vlerësimit të cenimit të interesave të komuniteteve. Komisioni për komunitete, vazhdoi, ka pasur mundësinë e intervenimit në kohën e caktuar përmes instancës tjetër (PSSP), gjatë leximit të parë etj, dhe “këtu thjesht kemi bllokim të projektligjit pa asnjë arsytim”, përfundoi.

Selvie Halimi parimisht përkrahu Naim Malokun por nuk kundërshtoi takimin me këtë komision sa për t'a hequr dilemën, pastaj ky komision më lehtë do të kishte për të raportuar me shkrim kryesinë lidhur me këtë projekt, përndryshe ajo tha se po na del një ligj politik.

Elheme Hetemi tha se ende nuk kemi marr asgjë nga ai komision, ndaj mirë është të insistohet për një përgjigje me shkrim ose të dërgojnë vërejtjet me shkrim ose të shkruajnë për arsyet e bllokimit të ligjit.

Zylfi Merxha anëtar i komisionit për komunitete, tha se projektligjin e ka bllokua minoriteti serb, prandaj është kërkuar sugjerim nga ndërkombëtarët. Ai propozoi që në mbledhjen e nesërm të komisionit për komunitete të prezantoi z. Morina për sqarime.

Nexhat Shatri nga presidenca tha se ky projektligj pikërisht është diskriminues për shqiptarët ngase personat e përndjekur para lufte nga pushteti serb nuk kanë pasur dokumente.

Naser Rugova kërkoi ndihmën e anëtarëve të komisionit që janë anëtarë në komisionin për komunitete dhe sqaroi për përpjekjet e tij me kryeparlamentarin rreth projektligjit në fjalë i cili është përgjigjur se duhet pritur riemërimin e kryetarit të ri të komisionit për shkak të shkuarjes së tij në funksionin e ri. Në vazhdim sugjeroi një kompromis dhe komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Komisioni për Komunitete që të dërgoi këtij komisioni përgjigje me shkrim lidhur me arsyet e ngecjes së gjertanishme të projektligjit për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

2. Mundësisht kjo përgjigje të dërgohet deri në premtën e ardhshme më 18.12.2009.

3. I ngarkuari nga ky komision Zef Morina të shikoj mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e dt. 9.12.2009 në komisionin për komunitete për sqarime sa më të mira lidhur me këtë projektligj.

Lidhur me projektligjin për **Organizmat e Modifikuar Gjenetiki**sh kryetari **Naser Rugova** njoftoi se kryesia ka nxjerr përfundimin me të cilin ky komision obligohet të bashkëpunoi me USAID dhe ICO për të sjellë pastaj rekomandimet.

Koordinatori i komisionit njoftoi se zyrtari i USAID ka kërkuar një kohë për përgjigje me shkrim, ndaj komisioni përfundoi që kjo çështje të mbetet për javën e ardhshme.

Për **Projektligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit** themelohet grupi punues nga : **Zef Morina, Myrvete Pantina dhe Elheme Hetemi.**

Kryetari gjithashtu njoftoi për një kërkesë nga Drejtori i ZRRUM për rizgjedhjen e tij apo ndërprerjen e detyrës sipas ligjit të ri ngase ai është i emëruar nga PSSP.

Për shkak të funksionit jozgjedhor të komisionit u sugjerua që i njëjti të drejtohet Qeverisë përkatësisht organeve kompetente të ministrisë përkatëse.

Komisioni drejtoi edhe një kërkesë për **Myrvete Pantinën** që të angazhohet në komisionin për Buxhet rreth **projektligjit për Mbrojtje nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguri nukleare**, të shikoj arsyet e ngecjes së procedimit, sepse siç tha kryetari **Naser Rugova** të gjitha projektligjet e cekura sot në këtë mbledhje janë në agjendën e agjencisë evropiane.

Koordinatori njoftoi se njohurit nga stafi janë që ky komision është tejet i ngarkuar ndaj kjo është arsyeja e vetme.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10. Mbledhja e radhës do të mbahet më 15.12.2009 me rendin e ditës lidhur me OMGJ dhe çështjet tjera të ndryshme që u kërkuan në mbledhjen e sotme.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova